



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 11 shtator 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara nga kuadri ligjor në fuqi, shqyrtoi çështjet e rendit të ditës dhe mori vendimet e mëposhtme:

U miratua licencimi i shoqërisë **“3X ENERGY”** sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga impianti fotovoltai me kapacitet të instaluar 70 MW, me vendndodhje në Saver, Bashkia Lushnjë.

Centrali pritet të nisë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31 dhjetor 2027. Vendimi parashikon një afat licencimi 30-vjeçar.

U miratua kërkesa e shoqërisë **“KRONOS KONSTRUKSION”** sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, Qarku Korçë. Centrali duhet të nisë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 26 mars 2029. Vendimi parashikon një afat licencimi 30-vjeçar.

U miratua kërkesa e shoqërisë **“Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a.”** për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 8.25 MW, me vendndodhje në anën e poshtme të digës së Zadejës, në HEC Vau i Dejës, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër, për një afat 25-vjeçar. Centrali duhet të nisë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30 tetor 2027.

U miratua kërkesa e shoqërisë **“BUSHTRICA 2017”** sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC **“Bushtrica 2”**, me kapacitet të instaluar 4.800 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, Njësia Administrative Qukës, Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, për një afat vlefshmërie të licencës deri më datën 27.10.2052. HEC-i, i cili është tashmë i ndërtuar, duhet të nisë ushtrimin e veprimtarisë brenda datës 30 shtator 2026.

U miratua kërkesa e shoqërisë **“ALBPOWER”** sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

U miratua kërkesa e shoqërisë **“GERTI”** sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

Licencimi shoqërohet me detyrime specifike rregullatore dhe teknike, të cilat subjektet duhet t'i përmbushin gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

U vendos fillimi i procedurës për miratimin e Rregullores **“Për rregullat dhe procedurat e regjistrimit, administrimit të regjistrit dhe pezullimit të statusit të Komuniteteve të Energjisë së**

Rinovueshme”, e cila përcakton rregullat për regjistrimin e KER-ve, administrimin dhe përditësimin e regjistrit, si dhe pezullimin e statusit të tyre. Dokumenti do t’i nënshtrohet konsultimit publik përpara miratimit përfundimtar.

U vendos fillimi i procedurës për miratimin e “Marrëveshjes Tip për Anëtarësimin në Komunitetin e Energjisë së Rinovueshme”, e cila përcakton kushtet e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe rregullat për prodhimin, konsumin, depozitimin, ndarjen dhe shitjen e energjisë së rinovueshme. Projektakti do t’i nënshtrohet konsultimit publik përpara miratimit përfundimtar.

Gjithashtu, në këtë mbledhje, u prezantua informacioni mbi kërkesën e FSHU sh.a. lidhur me trajtimin e rasteve të mosmarrëveshjeve civile ndërmjet titullarit të kontratës dhe përdoruesit ose poseduesit të objektit. Bordi vlerësoi se subjektet e licencuara duhet të ruajnë neutralitetin ndaj këtyre rasteve dhe të mos përdorin ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në këtë kuadër, u kërkuar hartimi i një procedure të unifikuar për trajtimin e rasteve të tilla, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s www.ere.gov.al dhe në Fletoren Zyrtare.